



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



100 Vjet Pavarësi



AUTORITETI I KONTROLLIT .. SHTETEROR TË EKSPORTEVE

RAPORTI VJETOR MBI KONTROLLIN E EKSPORTEVE 2011



AUTORITETI I KONTROLLIT SHETËROR TË EKSPORTEVE

Raporti vjetor mbi kontrollin e eksporteve 2011



Përkthimi, lekturimi dhe shtypja e këtij botimi është përkrahur nga UNDP/SEESAC nëpërmjet projektit të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë.

Qëndrimet e shprehura në këtë botim i përkasin Qeverisë së Shqipërisë dhe nuk përfaqësojnë qëndrimet e Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. Të punësuarit e caktuar dhe prezentimi i materialeve në këtë botim nuk ndikojnë në qëndrimet e Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara për sa i përket: 1) statusit legal, teritorit ose rajonit të shtetit, ose autoriteteve të tij; ose 2) shtrirjes së kufijve ose kufijve doganor.



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Numri i kopjeve
100

ISBN 978-86-7728-181-6



1. HYRJE.....	5
2. LEGJISLACIONI KOMBËTAR	8
2.1 LEGJISLACION MBI KONTROLLIN E EKSPORTEVE.....	8
2.2 LEGJISLACIONI LIDHUR ME VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË EKSPORTEVE	8
3. SISTEMI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE	9
3.1 AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE.....	9
3.2 KONTROLLI SHTETËROR MBI EKSPORTET	9
3.3 FAZAT E PROCESIT.....	10
3.4 DOKUMENTET LIGJORE TË LËSHUARA NGA AKSHE	12
3.5 VENDIMET	13
3.6 SANKSIONET	13
4. LISTA E MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË.....	14
5. REGJIME NDËRKOMBËTARE TË KONTROLLIT TË EKSPORTIT TË ARMËVE.....	15
6. SHQIPËRIA DHE ANGAZHIMET E SAJ NDËRKOMBËTARE.....	17
6.1 ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE	17
6.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	21
6.3 BASHKËPUNIMI ME INDUSTRINË.....	22
7. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITET NË TË ARDHMEN	23





1. HYRJE

Nevojat e ndërtimit të një sistemi efikas të kontrollit shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare (import, eksport, transit, transship) të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, dhe si rrjedhojë e pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në iniciativat e përbashkëta ndërkombëtare të mbikqyrjes së transferimeve ndërkombëtare të mallrave sensibile, sollën miratimin në datë 05.04.2007 të Ligjit Nr. 9707, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i indryshuar, i cili përbën edhe bazën ligjore të sistemit të kontrollit shtetëror shqiptar të eksporteve.

Në nenin 6 të tij, ky ligj përcakton kompetencat e institucioneve të cilat luajnë rolin kryesor në kontrollin e eksportit të mallrave strategjike.

Sipas këtij neni:

- a) Kuvendi vendos bazat ligjore të politikës për kontrollin e eksporteve,
- b) Këshilli i Ministrave harton dhe zbaton politikën shtetërore për kontrollin e eksporteve,
- c) Politika shtetërore në këtë fushë zbatohet edhe nga Autoriteti Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve, ministritë dhe subjektet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e eksporteve.

Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve është Autoriteti Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve (AKSHE), në bashkëpunim me ministritë dhe subjektet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e eksporteve.

Qëllimi kryesor i krijimit të sistemit të kontrollit shtetëror të eksporteve është mbrojtja e interesave të sigurisë kombëtare, mbajtja e angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre dhe kufizimin e transferimeve të armëve konvencionale, si dhe marrja e masave për shmangien e përdorimit të tyre për qëllime terroriste dhe të kundërligjshme.

Objektivat kryesorë të ndërtimit të këtij sistemi të kontrollit shtetëror të eksporteve janë:

- a) Përcaktimi i mundësisë së garantimit të liçensave dhe autorizimeve për subjektet (persona fizikë apo juridikë, publikë apo privatë) e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, që u jep atyre të drejtën e import-eksportit, tranzitit ose të kryerjes së negociatave të pasuara me nënshkrimin e marrëveshjeve ekonomike me jashtë, si dhe revokimin e këtyre lejeve kur këto subjekte shkelin legjisllacionin në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit.
- b) Përcaktimi i mundësisë për garantimin e dhënies së çertifikatave ndërkombëtare të importit dhe çertifikatave të përdoruesit të fundit.
- c) Vlerësimi i kushteve për regjistrimin pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të subjekteve të cilat kanë për qëllim kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.
- d) Vlerësimi i mundësisë për paraqitjen e propozimeve në Këshillin e Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 9707, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar vijoi veprimtaria për hartimin e akteve normative nënligjore, për kompletimin e bazës ligjore të veprimtarisë së kontrollit shtetëror kombëtar të eksporteve.

Aktualisht aktet normative nënligjore kryesore, të cilat bëjnë të mundur funksionimin me efikasitet janë hartuar nga AKSHE dhe janë miratuar më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave.





100 Vjet Pavarësi

Pjesë plotësuese e akteve nënligjore janë dhe Urdhërat e miratuara nga Kryetari i AKSHE-së, profili i të cilave ka të bëjë kryesisht me procedurat e brendshme, aspektet organizative dhe detajet specifike të veprimtarisë së kontrollit.

Në fund të muajit Gusht 2008, nisi krijimi i strukturës së Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me emërimin e Kryetarit të kësaj Agjencie, nga Ministri i Mbrojtjes.

Që nga ajo datë e deri më sot veprimtaria e AKSHE-së ka ecur në katër drejtime kryesore:

1. Trajnimi i personelit;
2. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë, bashkëpunimi me Autoritetet homologe, dhe pjesëmarrja në konferenca dhe seminare, në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve;
3. Hartimi i akteve normative nënligjore, për kompletimin e bazës ligjore të veprimtarisë së kontrollit shtetëror kombëtar të eksporteve.
4. Veprimtari efektive në lidhje me lëshimin e dokumentave ligjorë; liçensa, autorizime dhe certifikata.

1. Rekrutimi dhe trajnimi i personelit:

Rekrutimi dhe trajnimi i personelit të një institucioni të ri, duke marrë parasysh vështirësitë e një fushë veprimtarie kaq specifike, mund të konsiderohet tashmë i kompletuar. Paralelisht me rekrutimin e personelit është bërë e mundur pjesëmarrja në konferenca dhe seminare të ndryshëm për qëllime si trajnuese ashtu edhe bashkëpunuese me organizmat ndërkombëtarë dhe rajonale të fushës.

2. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë, autoritetet homologe dhe me industrinë:

Në këtë periudhë kohore, AKSHE ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të frytshëm me disa organe homologe dhe organizma ndërkombëtarë.

la vlen këtu të përmendim :

- **Zyrën e Kontrollit të Eksporteve dhe Sigurisë së Kufijve (EXBS, Export Control and Border Security).** EXBS ka dhënë kontributin e saj si në financimin e pjesëmarrjes së stafit të AKSHE-së në konferenca dhe seminarë të ndryshëm ashtu edhe në pajisjen me leteraturë të fushës së kontrollit të eksporteve. EXBS është shprehur e gatshme të bashkëpunojë dhe të mbështesë AKSHE-në edhe në të ardhmen, me qëllim ndërtimin e një sistemi efikas të kontrollit shqiptar të eksporteve;
- **Autoritetin e Kontrollit Shtetëror Gjerman "BAFA",** e cila luan një rol primar në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve në Bashkimin Evropian, dhe gjithashtu është përfaqësuesi lider i BE-së për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të kontrollit shtetëror të eksporteve. BAFA ka dhënë kontributin e saj në trajnimin e stafit të AKSHE-së dhe gjithashtu është shprehur e gatshme për një mbështetje gjithëpërfshirëse në të ardhmen;
- **Zyra informative për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta për Europën Lindore dhe Jug-Lindore (SEESAC)** ka qënë një mbështetës i fuqishëm AKSHE-së, duke organizuar aktivitete të ndryshme në nivel rajonal, seminare trajnime. Gjithashtu në bashkëpunim me këtë organizatë kemi publikuar Raportin Kombëtar Vjetor për vitin 2007-2008, Raportin kombëtar të vitit 2009, 2010 si dhe Raportet Rajonale të viteve 2008-2009-2010.
- **Instituti i kërkimit Ndërkombëtar të Paqes i Stokolmit SIPRI** ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në organizimin e seminareve dhe trajnimeve dhe vazhdojnë të jenë të gatshëm në për të kontribuar në të ardhmen;
- Gjithashtu janë marrë kontakte bashkëpunuese me organizma dhe autoritete ndërkombëtare të tjerë, bashkëpunim i cili pritet të thellohet në të ardhmen.

Raporti me industrinë

Duke qënë se industria është një nga aktorët kryesorë në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve, bashkëpunimi lind si një nevojë e domosdoshme. Me operatorët ekonomikë



të cilët kryejnë aktivitet tregtar në fushën e eksporteve janë zhvilluar takime në të cilat janë diskutuar problematika të ndryshme. Që në fillimet e krijimit të AKSHE-së, janë lidhur kontaktet me Dhomat e Tregëtisë dhe Industrisë nëpër rrethe. Përfaqësues të këtyre institucioneve kanë qënë rregullisht të ftuar në aktivitetet të cilat janë zhvilluar në Shqipëri nga AKSHE-ja.

3. Hartimi i akteve normative nënligjore, për kompletimin e bazës ligjore të veprimtarisë së kontrollit shtetëror kombëtar të eksporteve.

Hartimi i akteve normative nënligjore të parashikuar nga ligji Nr. 9707, datë 05.04.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, të cilat do të bënin të mundur funksionalitetin e plotë të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ka qënë prioriteti i kësaj agjencie që në momentet e para të krijimit të saj.

4. Lëshimi i dokumentave ligjorë; liçensa, autorizime dhe çertifikata.

Që prej datës 1 Qershor 2009, AKSHE ka filluar procesin operativ të punës me pajisjen e subjekteve me liçensa, autorizime e çertifikata për mallrat ushtarake dhe mallrat me përdorim të dyfishtë. Raporti vjetor i këtij viti është raporti i katërt i Republikës së Shqipërisë në kontrollin e eksporteve mbas atij për vitet (2007-2008), 2009 si dhe për vitin 2010.

Raporti përmban të dhënat mbi përshkrimin e legjislacionit kombëtar mbi sistemin e kontrollit të eksporteve për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, si dhe përshkrimin e fazave të procesit të liçensimit.

Bashkëlidhur gjëndet edhe lista kombëtare e mallrave objekte të kontrollit, kriteret për miratimin e saj dhe linket përkatëse.

Vëmendje më pas i dedikohet konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, regjimeve të armëkontrollit dhe detyrimeve që derivojnë nga ato. Në këtë këndvështrim, analizohet dhe pozicioni i Republikës së Shqipërisë në sistemin e kontrollit të eksporteve si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij me industrinë.

Pjesa përfundimtare e raportit përmban të dhënat në detaje mbi eksportet e mallrave ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë për vitin 2011.

Tabelat përshkruajnë të dhënat mbi destinacionin, sasinë, vlerën ekonomike, llojin e mallrave, kodin e mallrave të eksportuara etj.





100 Vjet Pavarësi

2. LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË EKSPORTEVE

2.1. LEGJISLACIONI MBI KONTROLLIN E EKSPORTEVE

Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007

“Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.01.2008

“Për organizimin, funksionimin dhe statusin e autoritetit të kontrollit shtetëror të eksporteve”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011

“Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 25.3.2009

“Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e ekspertizave dhe të kontrollit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 25.3.2009

“Për përcaktimin e procedurës së lëshimit të dokumenteve ligjore të garancisë në fushën e kontrollit shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 8.4.2009

“Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumentave ligjore”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 28.8.2003

“Për miratimin, në parim, të Kodit të Sjelljes së Bashkimit Europian për eksportin e armëve”

Urdhër i Kryetarit të AKSHE-së nr. 76, datë 30.12.2008

“Për përcaktimin e formatit të raportit, afatet dhe koha e paraqitjes së raporteve”

Urdhër i Kryetarit të AKSHE-së nr. 72, datë 30.12.2008

“Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”

2.2 LEGJISLACIONI I LIDHUR ME VEPRIMTARINË E AKSHE.

AKSHE gjatë ushtrimit të funksioneve të saj dhe bashkërendimit të punës me institucione të tjera shtetërore apo private zbaton dhe norma ligjore të ndërlidhura me kontrollin e eksporteve të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Ndër to të zbatueshëm janë:

Ligji Nr. 9723, datë 3.5.2007	” Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ”
Ligji Nr.10 081, datë 23.2.2009	“ Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë ”
Ligji Nr.8449, date 27.01.1999	“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”
Ligji Nr.7582, datë 13.7.1992	“Për Ndërmarrjet Shtetërore”
Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008	“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
Ligji Nr.7926, datë 20.4.1995	“Për Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”
Ligji Nr.10 433, datë 16.6.2011	“Për Inspektimin në Republikën E Shqipërisë”

3. SISTEMI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

3.1 AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE (AKSHE)

Në Republikën e Shqipërisë institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve është Autoriteti Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve, në bashkëpunim me ministrinë dhe subjektet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e eksporteve. Në këtë kontroll mund të angazhohen organizma të tjerë shtetërorë gjatë zbatimit të masave të marra në procesin e kontrollit të eksportit, si përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, me pëlqimin e institucionit të varësisë. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është institucion qendror, në varësi të Ministrisë të Mbrojtjes.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është institucioni shtetëror, i cili ka si objekt të veprimtarisë kontrollin shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë.

Gjithashtu është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit të eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Ky institucion:

- Kryen analizën dhe ekspertizën përkatëse në lidhje me mallrat dhe veprimtaritë objekte të eksportit. Ky kontroll përfshin të gjitha fazat e procesit duke filluar që nga faza e pre-licensimit, deri në kontrollin e mëtejshëm pasi subjekti është pajisur me licensë dhe në verifikimin e përdoruesit dhe destinacionit përfundimtar të mallit.
- Lëshon dokumentat ligjore: licensa, autorizime dhe çertifikata.
- Sanksionon shkeljet ligjore në fushën e kontrollit shtetëror mbi eksportet.
- Vigjilon mbi zbatimin e embargove.
- Shërben si pikë kontakti në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Një rol tejet të rëndësishëm, AKSHE luan gjithashtu falë kompetencës ligjore për të qenë pikë kontakti në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë, duke implementuar procedurat që derivojnë nga normat ndërkombëtare, vigjiluar mbi zbatimin e embargove të plota apo të pjesshme, me analizën e kujdesshme të destinacioneve dhe përdorimit përfundimtar dhe me shkëmbimin konstant të informacioneve në lidhje me subjektet tregtarë të përfshira në operacione të paligjshme.

3.2 KONTROLLI SHTETËROR MBI EKSPORTET

Kontrolli shtetëror i import-eksporteve mbi mallrat ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre është një iniciativë e përbashkët ndërkombëtare e cila lind si nevojë e mbikqyrjes së transferimeve ndërkombëtare të mallrave sensibël.

Normat ndërkombëtare kryesore në këtë fushë:

- Rezoluta 1540 e Këshillit të Sigurisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara përcakton në mënyrë specifike detyrimin për shtetet anëtare të OKB-së të marrin masa për kontrollin e transferimit të këtyre mallrave, duke ndërtuar sisteme efikase të kontrollit shtetëror.
- Rregullorja e Bashkimit Europian nr.428/2009, e datës 5 Maj 2009, si dhe një sërë pozicionesh dhe veprimesh të përbashkëta, të cilat ndërtojnë një sistem të ndërthurur të kontrollit të lëvizjes së mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë.
- Kodi i Sjelljes për Eksportin e Armëve i miratuar nga Bashkimi Europian, i implementuar në Republikën e Shqipërisë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 604, të datës 28.08.2003 "Për miratimin në parim të Kodit të Sjelljes së BE-së për eksportin e armëve".
- Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP mbi Rregullat e Përbashkëta në Lidhje me Kontrollin e Eksporteve të Mallrave Ushtarake dhe Teknologjive të tyre i cili ka zvendosuar Kodin e Sjelljes për Eksportin e Armëve



100 Vjet Pavarësi

- Norma që derivijonë nga marrëveshjet ndërkombëtare të mospërhapjes dhe të kontrollit të eksporteve si p.sh Marrëveshja e Wassenaar-it, Regjimi i Mospërhapjes në Sektorin e Raketave, Kodit të Hagës për parandalimin e raketave balistike etj. Grupi i Australisë, Konventa e Armëve Kimike, OPCW, (jemi anëtarë), Komiteti Zangger etj.
- Kontrolli shtetëror mbi këto mallra, përbën gjithashtu një nga kriteret e përmbajtur në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), i domosdoshëm për t'u plotësuar nga Shqipëria, për të hyrë në familjen europiane.

Kontrolli shtetëror mbi eksportet përfshin:

- Artikujt

Të gjithë artikujt që përfshihen në listat e përbashkëta të kontrollit të Bashkimit Europian, të cilat miratohen dhe azhurnohen çdo vit me Vendim të Këshillit të Ministrave (aktualisht listat në fuqi janë të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve"

Një listë i referohet mallrave ushtarake, ndërsa një tjetër mallrave me përdorim të dyfishtë.

Mallrat dhe teknologjitë ushtarake përfshijnë:

- produktet e paracaktuara për qëllime ushtarake (shembuj: armatime, municione)
- shërbimet e paracaktuara për qëllime ushtarake (shembuj: projektimi, montimi, riparimi)
- teknologjitë e paracaktuara për qëllime ushtarake (shembuj: informacioni, të dhënat teknike, asistencë teknike)

Mallrat me përdorim të dyfishtë përfshijnë:

Produkte të veçanta, pajisje, materiale, software dhe teknologji, që nuk janë të projektuara posaçërisht për qëllime ushtarake, si dhe për punë e shërbime të lidhura me to, të cilat, përveç përdorimit civil, mund të përdoren për qëllime ushtarake ose terroriste apo në projektimin, prodhimin, përdorimin e armëve të paracaktuara për qëllime ushtarake, armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre ose e pajisjeve eksplozive, bërthamore. (shembuj: materiale bërthamore, agjentë kimikë, bakteriologjikë, biologjikë dhe përgatitja toksike)

- Subjektet
 - Personat Fizikë që kryejnë aktivitete të lidhura me transferimet e artikujve të mësipërm
 - Personat Juridikë që kryejnë aktivitete të lidhura me transferimet e artikujve të mësipërm
- Aktivitetet
 - Eksporti
 - Importi
 - Tranziti
 - Transshipi
 - Veprimtaria Ndërmjetësuese

3.3 FAZAT E PROCESIT

Procesi i liçensimit për sa i përket subjekteve

Regjistrimi

Regjistrimi: për sa i përket subjekteve të përfshira në veprimtaritë të cilat kanë si objekt mallrat ushtarake duhet që si hap fillestar të regjistrohen pranë AKSHE, e cila i lëshon këtyre subjekteve një Çertifikatë Regjistrimi dhe mban një regjistër të subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare. Ky është momenti i parë i procesit të liçensimit të mirëfilltë.





Aplikimi

Subjektet tregtare të cilat dëshirojnë të pajisen me licensë, autorizim apo çertifikatë duhet të paraqesin pranë AKSHE-së dokumentacionin e kërkuar si dhe të plotësojnë formularin tip të kërkesës. Kriteret e kërkuara, dokumentacioni përkatës, përgjigjet ndaj pyetjeve më të shpeshta, pikat e informimit për publikun si dhe të gjitha informacionet e nevojshme gjenden të publikuara dhe në faqen e internetit www.akshe.gov.al.

Bashkëpunimi i AKSHE-së me subjektet tregtare

Për të bërë të mundur një sistem kontrolli efektiv dhe transparent, nevojitet një frymë bashkëpunimi midis AKSHE dhe subjekteve tregtare gjatë gjithë fazave të këtij procesi. AKSHE po përpaket të kryejë kontrollin shtetëror të eksporteve me procedura efiksase, të shpejta e transparente, duke ofruar të gjithë informacionin dhe asistencën e nevojshme. Personat fizikë/juridikë të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilët kanë marrë licensë/autorizim, duhet të bashkëpunojnë me stafin e ekspertëve të AKSHE për të lejuar kontrollin në fakt të mallrave të përfshira në listat e kontrollit.

Raportimi

Personat fizikë/juridikë të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilët janë pajisur me licensë/autorizim, çertifikatë ndërkombëtare importi, duhet të paraqesin çdo 3 muaj, një raport me shkrim pranë AKSHE -së, lidhur me situatën e:

- Transferimeve të mallrave të përcaktuara në këto dokumenta,
- Përdorimin e këtyre mallrave sipas qëllimit të deklaruar.

Personat fizikë/juridikë, të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave, në një afat kohor prej 10 ditësh nga data e kryerjes së transferimit për çdo parti malli, duhet të dërgojnë pranë AKSHE-së kopje të dokumentacionit të mëposhtëm:

- Licensë eksporti/importi,
- Dokument transporti ndërkombëtar,
- Deklaratë doganore,
- Fatura e mallit.

Procesi i kontrollit dhe licensimit për sa i përket Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ushtron një kontroll gjithëpërfshirës gjatë procesit të licensimit, i cili shtrihet në të gjithë harkun kohor përpara, gjatë dhe pas momentit të pajisjes së subjektit me dokumentin ligjor specifik.

Ky kontroll mund të ketë si objekt këto drejtime:

a) Kontrolli i dokumentacionit dhe i kërkesës.

Ky kontroll konsiston paraprakisht në verifikimin e saktësisë dhe korrektësisë së plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me procedurat ligjore në fuqi si dhe plotësimit në mënyrë korrekte të kërkesës për pajisje me dokument ligjor, e cila konsiderohet si faza e kontrollit të mirëfilltë të dokumentacionit.

b) Kontrolli teknik i ekspertëve.

Kjo fazë kontrolli i kushtohet verifikimit në fakt të mallrave, objekt i licensës, duke bërë krahasimin e të dhënave të përshkruara nga aplikanti, me ato të mallrave efektive.

Për sa i përket kësaj faze, është shumë e rëndësishme që subjekti të ketë bërë në mënyrë të saktë klasifikimin e duhur të mallrave sipas kodeve të listës së kontrollit, duke bërë të mundur që çdo mall i përfshirë në aplikimin për licensë të ketë kodin e saktë përkatës.

Ky kontroll konsiston në ekspertizën dhe analizën teknike të ekspertëve të AKSHE ose të organeve të tjera nëse është e nevojshme.





100 Vjet Pavarësi

Si hark kohor mund të jetë një kontroll që përfshin të gjitha fazat e procesit, pra jo vetëm një kontroll paraprak në fazën e pre-liçensimit, por mund të jetë dhe i mëvonshëm, për të verifikuar në fakt në momentet e transportit dhe në mbërritjen përfundimtare të mallit.

Kohëzgjatja maksimale e ekspertizës është 30 ditë nga data e sigurimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme, nëse nuk është i nevojshëm bashkërendimi i punës me institucionet e tjera të interesuara.

c) Kontrolli i liçensimit

Kjo fazë i përket vlerësimit të mirëfilltë të kërkesës. Në procesin e vendimmarrjes merren parasysh të gjitha aspektet objektive dhe subjektive, si kujdesi ndaj mallrave sensibël, vëndet nën embargo, respektimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, subjektet e përfshira në këtë transaksion si dhe subjektet ndërmjetësuese, përdoruesit e fundit, qëllimi i përdorimit përfundimtar të mallrave, aspekti financiar etj.

Ky është një kontroll mbi oportunitetin e pajisjes apo jo të subjektit me dokument ligjor, i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes.

Për të patur një sistem efikas të kontrollit mbi këto mallra në këtë proces përfshihen dhe organe të tjera shtetërore, veprimtaria e të cilëve ndërthuret me veprimtarinë e AKSHE. Për çdo aplikim gjatë procesit të vendimmarrjes bashkëpunohet dhe merret informacion nga organet e tjera shtetërore të specializuara si Shërbimet e inteligjencës SHISH, SHIU, si dhe rast pas rasti kërkohet informacion nga (Ministria e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, etj)

3.4 DOKUMENTET LIGJORË TË CILAT LËSHOHEN NGA AKSHE

LIÇENSA

1. Liçensë eksporti për mallrat ushtarake (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
2. Liçensë importi për mallrat ushtarake (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
3. Liçensë për veprimtari ndërmjetësuese e mallrave ushtarake (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
4. Liçensë eksporti për mallrat me përdorim të dyfishtë (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
5. Liçensë importi për mallrat me përdorim të dyfishtë (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
6. Liçensë për veprimtari ndërmjetësuese e mallrave me përdorim të dyfishtë (me një përdorim, e përgjithshme, e pakufizuar)
7. Liçensë për transferim të software ose të teknologjive nëpërmjet rrugëve elektronike.

AUTORIZIME

8. Autorizim për tranzitin ndërkombëtar të mallrave ushtarake në territorin e Shqipërisë.
9. Autorizim për transshipin e mallrave ushtarake në territorin e Shqipërisë.
10. Autorizim për tranzitin ndërkombëtar të mallrave me përdorim të dyfishtë në territorin e Shqipërisë.
11. Autorizim për transshipin e mallrave me përdorim të dyfishtë në territorin e Shqipërisë.
12. Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për mallrat ushtarake.
13. Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për mallrat me përdorim të dyfishtë.
14. Autorizim për eksportin e mallrave të destinuara për në shtetet që janë nën embargo.
15. Autorizim për eksportin e mallrave që nuk janë në listën e kontrollit (cach all)

DOKUMENTET E GARANCISË (ÇERTIFIKATAT)

16. Çertifikatë regjistrimi për mallrat ushtarake.
17. Çertifikatë ndërkombëtare importi për mallrat ushtarake.





100 Vjet Pavarësi

18. Çertifikatë e përdoruesit të fundit për mallrat ushtarake.
19. Çertifikatë e shpërndarjes së mallit për mallrat ushtarake.
20. Çertifikatë ndërkombëtare importi për mallrat me përdorim të dyfishtë
21. Çertifikatë e përdoruesit të fundit për mallrat me përdorim të dyfishtë
22. Çertifikatë e shpërndarjes së mallit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

3.5 VENDIMET

Vendimet mund të jenë:

- Lëshimi i liçensës/autorizimit
- Mosmarrja në shqyrtim dhe refuzimi i kërkesës
- Revokimi dhe pezullimi i kërkesës
- Shfuqizimi i liçensës.

3.6 SANKSIONET

Në rastet kur AKSHE verifikon shkelje administrative në procedurat dhe detyrimet nga ana e subjekteve tregtare atëherë mund ti sanksionojë me:

- Gjobë (në masat e parashikuara nga neni 31 i Ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import - eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar.
- Shfuqizim apo revokim të liçencës
- Çregjistrimin e subjekteve.





100 Vjet Pavarësi

4. LISTA E MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË

Për të përcaktuar saktësisht, se cilat do të jenë ato mallra ushtarake dhe mallra e teknologji me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit të AKSHE-së, në pikën 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9707, datë 05.04.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, theksohet se “Këshilli i Ministrave miraton çdo vit listën e mallrave që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve”.

Kjo listë mallrash u implementua në muajin Shkurt të vitit 2011, me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”.

Kjo listë mallrash, duhet të përditësohet çdo vit bazuar në nevojat e shtetit shqiptar në fushën e kontrollit të eksporteve, por edhe nga përmbushja e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë.

Përditësimi i kësaj liste është përputhje me listën e mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë paraqitur në Shtojcën I të Rregullores së Bashkimit Evropian Nr. 428/2009 të datës 5 Maj 2009, si dhe sipas Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian, Nr. 2010/C 69/03 (CFSP) për listën e mallrave ushtarake.

Lista e mallrave ushtarake dhe e mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, është implementimi nga ana e Republikës së Shqipërisë i listës së mallrave objekt i kontrollit të eksporteve të Bashkimit Evropian, dhe më saktë të listës së:

- a) Mallrave ushtarake dhe teknologjive të tyre, e cila është një listë e përfshirë në Pozicionin e Përbashkët (Joint Position) të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për miratimin e “Kodit të Sjelljes” (Code of Conduct). Pavarësisht faktit, që kjo listë paraqitet si një shembull konkret për vendet anëtare, të cilat janë të lira të miratojnë një listë të tyre të mallrave ushtarakë dhe teknologjive, duke mos qenë kështu juridikisht të detyruara të implementojnë tërësisht këtë listë, politikisht dhe praktikisht, këto shtete janë përshtatur plotësisht me këtë listë.
- b) Mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, e cila është një listë e miratuar me Rregulloren (EC) të Këshillit të Bashkimit Evropian, nr. 428/2009 të datës 5 Maj 2009, “Mbi përcaktimin e një regjimi të Komunitetit për kontrollin e eksporteve të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë”. Në këtë listë janë përfshirë të gjithë ato artikuj apo teknologji, të cilët kryesisht janë të projektuar për përdorim civil, por që në duar të gabuara, mund të përdoren fare mirë për qëllime ushtarake apo terroriste.

Lista e Mallrave Ushtarake

[http://www.akshe.gov.al/Mallrat Ushtarake.html](http://www.akshe.gov.al/Mallrat%20Ushtarake.html) (Link)

Lista e mallrave me përdorim të dyfishtë

[http://www.akshe.gov.al/Mallrat me perdorim te dyfishte.html](http://www.akshe.gov.al/Mallrat%20me%20perdorim%20te%20dyfishte.html) (Link)





5. REGJIME NDËRKOMBËTARE TË KONTROLLIT TË EXPORTIT TË ARMËVE

Edhe pse Legjislacioni Shqiptar mbi kontrollin e eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe lista kombëtare e kontrollit të mallrave ushtarake janë në përputhje standartet ndërkombëtare, Shqipëria nuk është ende pjesëmarrëse në disa marrëveshje ndërkombëtare në këtë fushë.

Qëllimet kryesore të këtyre regjimeve janë identifikimi i mallrave dhe teknologjive subjekte të kontrollit të eksporteve, shkëmbimi i informacionit mbi rrezikun e përhapjes si dhe promovimi i mospërhapjes të armëve të shkatërrimit në masë në vëndet jo-anëtare të tyre.

Ajo çka mund të themi me siguri, është fakti se aderimi në këto regjime mbetet një prioritet për Republikën e Shqipërisë. Në përputhje me këtë prioritet me anë të Urdhrit të Përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Nr. 957, datë 31.05.2010, është ngritur një grup pune ndërinstitucional, i cili do të bëjë të mundur fillimin e procedurave të negociimit për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Rregjimet e Mospërhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë të cilat janë si më poshtë:

1. Marrëveshja e Wassenaar-it
2. Grupi i Australisë
3. Grupi Furnizues Nuklear
4. Komiteti i Zangger-it
5. Regjimi i Kontrollit të Teknologjisë së Armatimit

1. **Marrëveshja e Wassenaar-it** është një regjim multilateral i kontrollit të eksportit me 40 shtete pjesëmarrëse. Eshtë krijuar mbas Komitetit të koordinimit të kontrollit multilateral të eksportit, në 12 maj, 1996 në Wassenaar, Hollandë. Sekretaria e administrimit të kësaj marrëveshje ndodhet në Vienë, Austri. Kjo marrëveshje ka për objektiv kontrollin e eksporteve të armëve konvencionale dhe mallrave me përdorim të dyfishtë. Anëtarësia në MW nuk krijon detyrime për shtetet anëtare. Vendimi për transfertë ose refuzim të transfertës të çdo materiali është përgjegjësi e çdo shteti anëtar. Të gjitha masat në lidhje me marrëveshjen meren në pajtim me politikat dhe legjislacionin kombëtar dhe implementohen në bazë të interesave kombëtare.

2. **Grupi i Australisë**, është një regjim jo formal shtetesh i krijuar në vitin 1985 (pas përdorimit të armëve kimike nga Iraku në vitin 1984) për të ndihmuar në reduktimin e përhapjes të armëve kimike e biologjike me anë të monitorimit dhe kontrollimit të teknologjisë që shërben për prodhimin e tyre. Numri i anëtarëve të grupit nga 15 u rrit në 41, duke përfshirë të gjithë vëndet anëtare të OECD përveç Meksikës, 27 shtetet anëtare të BE, Kroacinë, Ukrainën dhe Argentinën. Grupi përmban një listë të përbashkët teknologjive që mund të përdoret në programe kimike dhe biologjike të armëve, të cilat kanë kufizime të eksportit. Pjesëmarrësit nuk ndërmarrin kurrfarë obligimesh ligjore. Efektiviteti i bashkëpunimit midis tyre varet vetëm nga angazhimi për mos prodhimin e armëve kimike dhe ndalimit të shpërndarjes së tyre.

3. **Grupi Furnizues Nuklear**, është një organizatë shumëkombëshe që ka për qëllim mosprodhimin e armëve nukleare nëpërmjet implementimit të udhëzimeve për eksportet nukleare dhe atyre të lidhura me to. Ky grup kontrollon eksportin dhe transferimin e mallrave që mund të përdoren për zhvillimin e armëve nukleare. Eshtë krijuar në vitin 1974 mbas testit nuklear Indian që vërtetoi se disa lloje teknologjish nukleare specifike që nuk janë armatime mund të kthehen në të tilla. Pas një serie takimesh në Londër nga viti 1974 në fund të vitit 1978 u ra dakord mbi udhëzimet e këtyre lloj eksporteve. Këto udhëzime janë implementuar nga çdo shtet anëtar në pajtim me ligjet dhe praktikat kombëtare. Vendimet për aplikimet merren në nivel kombëtar, duke u përshtatur me kërkesat kombëtare për liçensim të eksporteve.

4. **Komiteti i Zangger-it**, i njohur gjithashtu si komiteti i eksportuesve të armëve nukleare, i krijuar nga neni III, 2 i Marrëveshjes së Mosprodhimit të Armëve Nukleare, hyri në fuqi në 5 mars 1975. Sipas termave të këtij neni, mbi eksportin e armëve nukleare duhet të aplikohen masat





100 Vjet Pavarësi

e sigurimit të hartuara nga Agjencia e Energjisë Atomike Ndërkombëtare. Ky Komitet ofron një sërë udhëzimesh për të gjitha shtetet palë në këtë marrëveshje.

5. **Regjimi i Kontrollit të Teknologjisë së Armatimit, (RKTA)**, e cila është negociuar dhe implementuar nga Dr. Richard H. Speier, është një marrëveshje jo formale vullnetare midis 34 vendeve për të parandaluar prodhimin e pakontrolluar të teknologjisë për armët e shkatërrimit në masë. Kjo iniciativë ka për objektiv të saj mosprodhimin e sistemeve autonome, të afta për shpërndarje të armëve të shkatërrimit në masë dhe koordinimin e liçensave kombëtare të eksporteve që synojnë parandalimin e prodhimit të tyre.
6. **Kodi i Hagës për parandalimin e raketave balistike**, ka hyrë në fuqi në Nëntor 2002 në Hagë. Kodi është konceptuar si suplement i (RKTA), por anëtarësimi në të nuk është i kufizuar. Ky Kod paraqet detyrime politike të shteteve pjesëmarrëse me qëllim mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë, Raketave Balistike si dhe të ushtrisë kufizim maksimal në zhvillimin, testimin dhe vendosjen e këtyre raketave në pozicione luftarake.



6. SHQIPËRIA DHE ANGAZHIMET E SAJ NDËRKOMBËTARE

6.1 ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE

Prej vitesh Republika e Shqipërisë është përkushtuar në aplikimin dhe aderimin në Paktet dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Çarmatimin, Mospërhapjen dhe Kontrollin e Armëve. Këto Marrëveshje janë tashmë pjesë e legjislacionit Shqiptar dhe përforcohen në vazhdimësi. Shqipëria është palë nënshkruese e Marrëveshjeve Ndërkombëtare që vijojnë:

Aktet Ndërkombëtare ku bën pjesë Republika e Shqipërisë

1. Konventa mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (me Protokollet I, II, III), bërë në Gjenevë, më 10.10.1980.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 02.12.1983

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 28.08.2002

2. Protokolli shtesë i Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (Protokolli IV, i titulluar Protokolli mbi armët verbuese lazer), bërë në Vjenë, më 13.10.1995.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 30.07.1988

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 28.08.2002

3. Protokolli mbi Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të Minave, ose Grackave dhe pajisjeve të tjera, e ndryshuar më 3.05.1996 (Protokolli II i ndryshuar më 3 maj 1996), i aneksuar i Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte, bërë në Gjenevë, më 03.05.1996.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 3.12.1998

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 28.08.2002

4. Ndryshimi Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte, bërë në Gjenevë, më 21.12.2001;

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 18.05.2004

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 12.05.2006

5. Protokolli mbi Mbetjet Eksplozive të Luftës të Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (Protokolli V), bërë në Gjenevë më 28.11.2003.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 12.11.2006

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 12.05.2006

6. Konventa mbi Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, Magazinimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe Shkatërrimin e tyre, bërë në Gjenevë, më 03.09.1992.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 29.04.1997





100 Vjet Pavarësi

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 14.01.1993

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 11.05.1994

7. Traktati mbi Ndalimin e testeve bërthamore, bërë në New York, më 10.09.1996.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: Nuk ka hyrë ende në fuqi

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 27.09.1996

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 23.04.2003

8. Konventa për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të Minave Anti-person dhe për shkatërrimin e tyre, (Convention of the Prohibition of the Use, Stockpiling, Production and Transfer of Anti-Personnel Mines and on Their Destruction), nënshkruar në Otava, më 3-4 dhjetor 1997.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 01.03.1999

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 08.09.1998

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 29.02.2000.

9. Marrëveshja e Mospërhapjes së Armësve Nukleare (Nuclear Non-Proliferation Treaty, NNPT or NPT), bërë në New York, më 1.07.1968.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 5.03.1970

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë:

12 Shtator 1990 (L) (Londër);

14 Shtator 1990 (M) (Moskë);

28 Shtator 1990 (W) (Washington).

10. Konventa e Armëve Kimike (Chemical Weapons Convention, CWC), bërë në Paris, më 13.01.1993.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 29.04.1997

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 14. 01. 1993

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 23.05.1994

11. Konventa e Armëve Biologjike dhe Helmuëse (Biological and Toxic Weapons Convention, BTWC), bërë në Londër, Moskë dhe Washington, më 10.04.1975.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 26.03.1975

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 3.06.1992

12. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA) për zbatimin e garancive në të gjitha veprimtaritë bërthamore të Shqipërisë, IAEA krijuar më 23 tetor 1956.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 29.07.1957

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 25. 03. 1988

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 25.03. 1988

13. Protokolli shtesë i Marrëveshjes së garancive në të gjitha veprimtaritë bërthamore të Shqipërisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA), nënshkruar më 22 shtator 1998.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 30 prill 2004

Data e nënshkrimit nga Shqipëria: 2 dhjetor 2004

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë:





14. Protokollin e Gjenevës (Protocol for the Prohibition of the Use in War of Asphyxiating, Poisonous or other Gases, and of Bacteriological Methods of Warfare), nënshkruar në Gjenevë, më 17 korrik 1925.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 8 korrik 1928

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 20 dhjetor 1989

Republika e Shqipërisë merr të gjitha masat dhe instrumentet e nevojshme për mospërhapjen dhe kontrollin e armëve, duke njohur dhe zbatuar marreveshjet e mëposhtme:

MARREVESHJE MBI ARMET KONVENCIONALE DHE ARMET E VOGLA DHE TE LEHTA	ANGAZHIMI I SHQIPERISE
Kodi European i Sjelles në Eksportin e Armëve	Gusht 2003
Dokumenti i OSCE mbi Armët e Lehta dhe të Vogla(SAWL)	Nëntor 2000
Documenti i OSCE mbi Depot e Municioneve Konvencionale	Dhjetor 2003
Vendimi i OSCE mbi MANPADS (Sisteme të mbrojtjes ajrore të manovrueshme)	2003
Vendimi i OSCE mbi Certifikatat e Përdoruesit të fundit	2004
Vendimi i OSCE mbi Brokering	2004
Plani Implementues për Paktin e Stabilitetit Rajonal	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara mbi Armët e Vogla dhe te Lehta	2001

Ligje të tjera të aplikuara janë:

- Ligji nr. 7532 datë 11.12.1991 Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për ndalimin e zhvillimit , të prodhimit e të mbatjes stok të armëve bakteriologjike (biologjike) dhe toksinave, si dhe shkatërrimin e tyre"
- Ligji nr.7747, datë 29.7.1993 Për ratifikimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, stokimit e përdorimit të armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre"

Shqipëria ka gjithashtu detyrimin ligjor për të raportuar:

- Programit të Kombeve të Bashkuara që vepron mbi armët e vogla dhe të lehta
- Regjistrin të armëve konvencionale të Kombeve të Bashkuara

Marrëveshje Ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare:

1. Marrëveshja e Mospërhapjes së Armëve Nukleare (MMP)
2. Konventa e Armëve Kimike (KAK)
3. Konventa e Armëve Biologjike dhe Helmuese (KABH)
4. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (ANEA)

1. **Marrëveshja e Mospërhapjes së Armëve Nukleare** është ligjërish e detyrueshme. Ajo u njeh shteteve të drejtën për të marrë pjesë në këmbimin e pajisjeve, materialeve dhe informacioneve për përdorim paqësor të energjise atomike. Neni 1 i kësaj marrëveshjeje detyron shtetet anëtare që zotërojnë armë nukleare të mos transferojnë asnjë lloj armë nukleare ose pajisje të kësaj natyre.
2. **Konventa e Armëve Kimike** është një marrëveshje ligjërish e detyrueshme që ndalon zhvillimin, prodhimin, grumbullimin, transferimin dhe përdorimin e armëve kimike dhe ka për objektin zhdukjen e tyre. Ajo u jep të drejtën shteteve anëtare të bëhen pjesëmarrëse në këmbime ndërkombëtare të informacioneve shkencore, materialeve kimike dhe pajisjeve për qëllime të lejuara nga konventa.





100 Vjet Pavarësi

3. **Konventa e Armëve Biologjike dhe Helmuese** është një marrëveshje ligjërishme e detyrueshme që ndalon zhvillimin, prodhimin, grumbullimin, furnizimin dhe mbajtjen e armëve biologjike si dhe mënyrat për shpërndarjen e tyre. Shtetet anëtare të kësaj konvente kanë të drejtën të marrin pjesë në këmbimin e pajisjeve, materialeve dhe informacioneve nëse ky shkëmbim ka qëllim paqësor.
4. **Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (ANEA)** është një qëndër kooperimi botërore në fushën nukleare. Ajo u krijua në 1957 si organizata botërore "Atome për paqe" në Kombet e Bashkuara. Agjencia punon me shtetet e saj anëtare dhe partnerët në mbarë botën për të promovuar sigurinë dhe paqen e në fushë e teknologjive nukleare.

Misioni i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike drejtohet nga interesat dhe nevojat e shteteve anëtare, planeve strategjike si dhe visioneve të kësaj agjencie.

Tre fushat kryesore të misionit të kësaj agjencie janë:

- Mbrojtja dhe Siguria
- Shkenca dhe Teknologjia
- Verifikimet dhe Masat Paraprake të Mbrojtjes

Dikur Shqipëria zotëronte një stok armësh të shkatërrimit në masë. Ky stok armësh kimike përbante 16,678 kilogram lëndë kimike.

Shqipëria ishte një nga vendet e para që firmosi Konventën e Armëve Kimike (KAK) në vitin 1993. Kjo marrëveshje që hyri në fuqi në po të njëjtin vit, kërkonte deklarimin e stoqeve kimike, shkatërrimin e armëve kimike dhe të mënyrave të prodhimit apo transferimit tyre. Shqipëria është një prej 6 vendeve të cilat kanë deklaruar për posedimin e armëve kimike në mars të vitit 2003, pas zbulimit në dhjetor të 2002-it, të 600 kontenerëve kimikatesh në një bunker të braktisur.

Në 11 korrik 2007, Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (ONAK) konfirmoi shkatërrimin total të stokut të armëve kimike në Shqipëri, duke bërë në këtë mënyrë Shqipërine vendin e parë që shkatërroi totalisht armët kimike sipas termave të kësaj konvente (KAK). Shtetet e Bashkuara asistuan dhe financuan këtë operacion shkatërrimi. Organizata e ndalimit të armëve kimike synon eliminimin total të armëve kimike në të gjithë botën. (ONAK) ka për mision kryesor verifikimin e shkatërrimit e të gjitha armëve kimike ekzistuese, dhe të marrë masat e duhura për ti dhënë fund fabrikimeve të këtyre lloj armëve. Kjo organizatë u siguron asistencë dhe mbrojtje të gjitha shteteve pjesëtare, që janë objekt kërcënimi apo sulmi me armë kimike. Vetëm 11 vjet pas hyrjes në fuqi në vitin 1997, (ONAK) ka mbledhur rreth 185 shtete. Katër vende të tjera e kanë firmosur, duke sjellë kështu të gjithë mbështetjen e tyre politike ndaj objektivave dhe parimeve të kësaj konvente. Vetëm 6 shtete, që nuk kanë firmosur, mbeten ende jashtë (ONAK). Është shumë e rëndësishme që këto shtete të aderojnë sa më shpejt të jetë e mundur për të siguruar ndalimin total të armëve kimike dhe për të fituar sigurinë si dhe avantazhet ekonomike që (ONAK) i ofron shteteve anëtare.

Duke rikujtuar gjithashtu, se Shqipëria ka aderuar në Konventën e Armëve Biologjike në 3 qershor të vitit 1992 për ndalimin e armëve biologjike. Ajo ka aderuar edhe në Marrëveshjen e Mospërhapjes të Armëve Nukleare në shtator 1990. Shqipëria i është bashkëngjitur Protokollit të Gjenevës në 20 dhjetor 1989, Për Ndalimin e Armëve Biologjike dhe Kimike.

Shqipëria ka kërkuar të bëhet pjesë e Marrëveshjes së Wassenaar-it për kontrollin e exportit të armëve konvencionale dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, në prill të 2004 (Vendim të Këshillit Ministrave nr.248, prill 2004).

Në të njëjtën kohë me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 28 gusht 2003, Shqipëria implementoi Kodin e Sjelljes Europiane (EU Code of Conduct), i cili është zëvendësuar nga Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP mbi Rregullat e Përbashkëta në Lidhje me Kontrollin e Eksporteve të Mallrave Ushtarake dhe Teknologjive të tyre. Ky kod është i përbërë nga tetë kritere dhe aplikohet nga të gjitha shtetet anëtare mbi eksportet e armëve.





6.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ashtu si në krijimin e AKSHE-së edhe përgjatë gjithë veprimtarisë së saj, asistenca e dhënë dhe bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare të fushës ka qenë një ndihmesë e madhe për përgatitjen dhe trajnimin e stafit të specializuar në kontrollin shtetëror të eksporteve. Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme ndërkombëtare ka qenë i frytshëm si në krijimin, adaptimin ashtu edhe në implementimin e bazës ligjore në fushën e kontrollit të eksporteve.

Ndër Partnerët tanë kryesorë në këtë fushë mund të përmendim, Export Control and Related Border Security Program (EXBS), zyrë e ngritur nga Departamenti Amerikan i Shtetit, si dhe BAFA (Gjermani) për llogari të EU Cooperation Under the Long Term Project (LTP), Zyra informative për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta për Europën Lindore dhe Jug-Lindore (SEESAC), Stockholm International Peace Research Institute, SIPRI,

Gjithashtu me mbështetjen financiare të Qeverisë Amerikane (Departamentit të Shtetit), Gjermanisë (BAFA), SEESAC, SIPRI, si dhe me vetëfinancim, janë mbajur seminare dhe grupe pune të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Shqipërisë, me përfaqësues të institucioneve analoge në fushën e kontrollit të eksporteve:

1. Workshop i organizuar nga OSBE në Janar 2011, mbi rolin e OSBE në Implementimin e Rezolutes 1540, në Austri
2. Seminar i organizuar nga RACVIAC dhe OPCW Mars 2011, mbi Konventën e Armëve Kimike në Kroaci
3. Takimi i katërt rajonal i shkëmbimit të informacionit të Eksportit të Armëve i organizuar nga SEESAC në Mars 2011, Kroaci
4. Sesioni i 64 i Keshillit Ekzekutiv të OPCW në Maj 2011 Hagë/ Hollandë
5. Seminar mbi kontrollin e Eksportit të armëve në vendet e Ballkanit Perëndimor i organizuar nga (BAFA dhe BE) në Maj 2011, Mali i Zi
6. Takimi i 10 i Autoriteteve Kombëtare të shteteve palë të Europës Jug-Lindore OPCW në Maj 2011, Estoni
7. Kurs trajnues mbi mbrojtjen civile nga armët kimike i organizuar nga OPCW dhe Republika Çeke në Maj 2011, Çeki
8. Konferenca e 12 Ndërkombëtare për Kontrollin e Eksporteve e organizuar nga BE dhe SHBA në Maj 2011 në Singapor
9. Takimi i pestë rajonal i shkëmbimit të informacionit të Eksportit të Armeve i organizuar nga SEESAC në Qershor 2011, Mali i Zi
10. Seminar mbi forcimin e kontrollit të eksporteve të mallrave me perdorim të dyfishtë si dhe menaxhimi i riskut, roli i doganes organizuar nga BAFA në Tetor 2011 Shqipëri,
11. Seminarin rajonal i organizuar nga BAFA, në kuadër të Projektit afatgjatë me BE-në, mbi denimet për shkelje të kontrollit të eksporteve Tetor 2011 Kroaci.
12. Seminarin rajonal i organizuar nga BAFA, në kuadër të Projektit afatgjatë me BE-në, mbi Licensimin dhe procedurat doganore, Integrimin e procedurave kombëtare të mallrave me perdorim të dyfishtë dhe Armëve Konvencionale nëpërmjet Shkëmbimit të Informacionit. Tetor 2011 Kroaci
13. Konferenca e 7-të e BWC të Europës Juglindore e organizuar nga BE dhe Ministria e Jashtme e Republikës së Serbise Nëntor 2011 Serbi





100 Vjet Pavarësi

14. Takimi i gjashtë rajonal i shkëmbimit të informacionit të Eksportit të Armëve liorganizuar nga SEESAC në Nëntor 2011, Mali i Zi
15. Seminar mbi Çështjet teknike të lidhura me implementimin e regjimit të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë, organizuar nga Komisioni Europian, Nëntor 2011 Itali
16. Takimi i 13 vjetor i Autoriteteve Kombëtare të OPCW i organizuar nga OPCW Nëntor 2011 Hollandë
17. Workshop mbi implementimin e masave kufizuese, i organizuar nga Komisioni Europian (instrumenti TAIEX) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të ish Rep Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) Dhjetor 2011 Maqedoni

6.3 BASHKËPUNIMI ME INDUSTRIJË

Duke qënë se industria është një nga aktorët kryesorë në kontrollin e eksporteve, bashkëpunimi lind si një nevojë e domosdoshme. Me operatorët ekonomikë të cilët kryejnë aktivitet tregtar në fushën e eksporteve janë zhvilluar takime në të cilat janë diskutuar problematika të ndryshme. Që në fillimet e krijimit të AKSHE-së, janë lidhur kontaktet me Dhomat e Industrisë dhe të Tregtisë nëpër rrethe. Përfaqësues të këtyre institucioneve kanë qënë rregullisht të ftuar në aktivitet të cilat janë zhvilluar në Shqipëri nga AKSHE-ja.

Në këto seminare kanë marrë pjesë përfaqësues të dhomave të Industrisë dhe Tregëtisë, Tiranë, Durrës, Vlorë, si dhe përfaqësues të subjekteve tregtarë të cilët operojnë në këtë fushë. Gjatë këtyre seminareve pjesëmarrësit janë njohur me lëgjislacionin kombëtar dhe atë të BE, me procedurat dhe procesin e liçensimit, listën kombëtare mbi mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë etj.

Për të lehtësuar dhe për të patur një informacion sa më të disponueshëm AKSHE, ka edhe një adresë zyrtare www.akshe.gov.al, ku subjektet mund të gjejnë format e aplikimeve, procedurat që duhet të ndjekin, legjislacionin si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme.



7. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITET NË TË ARDHMEN

Objektivat aktuale më të ngutshme të AKSHE-së janë:

Aktivitetet trainuese të AKSHE-së, si seminarët, kurset e trajnimit, grupet e punës mbi implementimin e legjislacionit kombëtar si dhe përshtatjen sa më efektive me normat ndërkombëtare në fushën e kontrollit të eksporteve duhet të vazhdojnë edhe më tej. Për këtë nevojitet mbështetja e komunitetit ndërkombëtar dhe padyshim, një bashkëpunim me institucionet të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me këtë fushë, duke përfshirë dhe industrinë.

Për përmirësime të mëtejshme në fushën e import – eksport kontrollit nevojitet:

- Zhvillimi i legjislacionit kombëtar me akte nënligjore si dhe implementimi i legjislacionit ekzistues në fushën e kontrollit të import-eksport të mallrave ushtarake si dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë nga të gjithë aktorët pjesëmarrës në këtë fushë.
- Ndryshimet e nevojshme në ligjin të Ligjit Nr. 9707, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, në përputhje edhe me Rregullonën e BE-së, 428/2009
- Forcimi më tej i bashkëpunimit me institucionet shtetërore të cilat janë pjesë e sistemit të kontrollit shtetëror shqiptar të eksporteve dhe nënshkrimi i protokolleve teknike dypalëshe midis AKSHE-së dhe këtyre institucioneve si Doganat, Ministria e Jashtme, SHISH, Ministria e Ekonomisë etj.
- Plotësimi i angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë që vijnë nga anëtarësia në Kombet e Bashkuara si dhe nga rezoluta, rekomandime dhe dokumente të tjera lidhur me parandalimin e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe luftës ndaj terrorizmit.
- Vazhdimi i procedurave të hyrjes së Shqipërisë në traktatet ndërkombëtare dhe regjimet e kontrollit si anëtare e, Marrëveshjes së Wassenarit (WA), Grupit të Australisë (AG), Regjimi i kontrollit të Teknologjisë së Raketave (MTCR), Grupi i Furnizuesëve Bërthamorë (NSG), dhe Komiteti Zangger (ZC).
- Krijimin e një bashkëpunimi rajonal sa më efektiv në fushën e kontrollit të eksporteve.
- Vazhdimin në pjesëmarrjen e EU Cooperation under the Long term project (LTP)
- Vazhdimësia e punës duhet të sjellë shtimin e shkallës së profesionalizmit me qëllim ushtrimin efikas të kompetencave ligjore.





100 Vjet Pavarësi

Annex 1 EKSPORTET E LIÇENSUARA DHE TË REALIZUARA TË MALLRAVE USHTARAKE PËR VITIN 2011

Shteti End User	Numri i Licensave	Lloji i Mallit	Kodi sipas listes se kontrollit	Vlera sipas Liçensës	Realizimi efektiv
Republika e Çekisë	1	Municion 7.62x54 mm	ML 3	1.250.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
		Municion 12.7x108 mm		3.000.000 \$	
Yemen	1	Predha Mortaje 120mm	ML 3	300.000 \$	300.000 \$
		Fishekë 12.7x108 mm		1.200.000\$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Republika e Gjeorgjisë	1	Raketa 64 mm ZOJA	ML 4	1.260.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Burkina Faso	1	Mortajë 60, Mortajë 82, Mortajë 120 mm	ML 1	4800 \$ 4500 \$ 6000 \$	4800 \$ 4500 \$ 6000 \$
		Municion 7.62x39, 7.62x54, 12.7x108	ML 3	55.430 \$	55.430 \$
		PG-7 V 40mm RPG-7	ML 3	6000\$	6000\$
		Predha Mortaje 60,82,120mm	ML 3	4120 \$	4120 \$
Republika e Kosovës	1	Fishekë Pistoletë 9x19mm	ML 3	17.333.000 AL	2.554.442 AL
USA	1	Pushkë model M53	ML 1	600.000 \$	600.000 \$
Emiratet e Bashkuara Arabe	1	Fishekë 12.7x108 mm	ML 3	240.000 \$	240.000 \$
Bullgari	1	Shtimje 82,120 mm	ML 3	4.000.000 \$	959.730 \$
		Predhë për Obus 122mm	ML 3	300.000 \$	184.000 \$
		Plasës M-12,M429	ML 3	32.000 \$	19.926 \$
Republika e Çekisë	1	Fishekë 7.62x56 mm	ML 3	300.000 \$	352.170 \$
		Fishekë 7.62x53 mm	ML 3	600.000 \$	
Republika Dem. e Kongos	1	Mortaja 82	ML1	60.000 \$	60.000 \$
		Martaja 120 mm		30.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
		Predha mortaje 120 mm	ML 1	150.000 \$	150.000 \$
		Granatahedhës te montuar në tytë	ML 1	450.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Republika e Çekisë	1	Municion 7.62x31 mm	ML 3	900.000 \$	443.664 \$
		Municion 7.62x54 mm	ML3	750.000 \$	174.636 \$





Annex 2 IMPORTET E LIÇENSUARA DHE TË REALIZUARA TË MALLRAVE USHTARAKE PËR VITIN 2011

Eksportuesi	Numri i Licensave	Lloji i Mallit sipas Licensës	Kodi sipas listës së Kontrollit	Vlera sipas Liçensës	Realizimi efektiv
Izrael	1	G-303 Tear Gas	ML 7	37.260 €	37260 €
		G-717 Blast CD	ML 7	31.050 €	31.050 €
		Protectojet Model 5	ML 7	71.480 €	71.480 €
		Refilling Kit for Model 5	ML 7	31.900 €	31.900 €
Kina	1	Gas Mask	ML 7	226.500 €	226.500 €
		Filter for gas mask	ML 7	41.250 €	41.250 €
Mali i Zi	1	Raketa 64 mm ZOLJA	ML 4	1.200.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Çeki	1	Fishekë 9 mm	ML3	63.500 €	63.500 €
Bosnje Hercegovinë	1	Kapsolla 4,5/3-P1	ML 1	48.750 €	16.425 €
Itali	1	Pjesë këmbimi për pistoletë	ML 1	0	Total
Serbi	1	Barut për municion	ML 1	28.000 €	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Bullgari	1	Granathedhes te montuar në tytë	ML 1	427.000 \$	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
Gjermani	1	Dylbi Stainer Military	ML 5	3390.59 €	3390.59 €
Itali	1	Pistoletë 9x19 mm (Pjesë këmbimi)	ML 1	16.000 €	16.000 €
		Pushkë AR 5.56x45 mm (Pjesë këmbimi)	ML 1	222.00 €	222.00 €
		Pushkë Snajper (Pjesë këmbimi)	ML 1	92.500 €	Zero realizim për periudhën e vlefshmërisë së liçensës
		Pushkë Gjysëm automatike (Pjesë këmbimi)	ML 1	76.000 €	76.000 €





100 Vjet Pavarësi

Annex 3 LIÇENSA IMPORTI PËR MALLRAT ME PËRDORIM TË DYFISHTË TË LËSHUARA NGA AKSHE PËR 2011

NR	Shteti i Origjinës/ Eksportuesi	Kodi Sipas Listes se Kontrollit	Lloji i Mallit	Sasia Copë	Vlera
1	Poloni/Hollandë	5A002	Web Security S160	2	29572 USD
1	Finland/Finland	5A002	Traffica Z5 Nols	3	79520 E
1	Poloni/Sloveni	5A002	Ironport C160	4	14410 USD
1	USA, Kina/USA, Kina	5B001 3A226 5A002.a.1 5A002.a.1	Side Cutting pliers Cable Assy Power Portserver Swich Assy	1 119 4 10	98,870 USD
1	Gjermani/Gjermani	1A004.a	Maska Fytyre 3-S	800	26744 USD
1	Irlandë/Irlandë	5D002A	Appliance XML VX 4000	2	54000 USD
1	USD/Gjermani	0C003 0C003	Anthracene-D10 ml in Methylene chloride Benzene – D6 2000 ml in methanol	1 ml 1 ml	253 E

LIÇENSA IMPORTI TË PËRGJITHSHME PËR MALLRAT ME PËRDORIM TË DYFISHTË TË LËSHUARA NGA AKSHE PËR 2011

NR	Shteti i Origjinës/ Eksportuesi	Kodi Sipas Listes se Kontrollit	Lloji i Mallit	Sasia Copë	Vlera
1	USA/USA	I papërcaktuar	Sipas Kontratës së Miratuar me VKM nr 665 dt 18.12.2002	E papërcaktuar	E papërcaktuar





PERSONAT JURIDIK SHTETËROR/PRIVAT TË REGJISTRUAR DHE TË PAJISUR ME ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI.

Nr	Subjekti	Adresa
1	Ndërmarrja Shtetërore "MEICO"	Rr."4 shkurti "nr.5, Tiranë
2	"ARMS & B" sh.p.k	Rr."Urani Pano" Pallati i Ri, Tiranë
3	"Klik Ekspo Group" sh.p.k	Bul.Dëshmorët e Kombit Hot.Rogner Europapark
4	Ministria e Mbrojtjes	Bul.Dëshmoret e Kombit, Tiranë
5	Ndërmarrja Shtetërore "Uzina Lëndëve Plasëse Mjekës"	Mjekës, Elbasan.
6	"Albafire" sh.p.k	Rr."Emin Duraku",Nr.15/1 Tiranë
7	"Shila Dreams" sh.p.k	Lagjja 1, Rr.Pjetër Arbunori Bathore, Kamëz, Tiranë
8	"Eni-Arb" sh.p.k	Rr."I. Qemali", Pallati i Ri Kati2, Zyra 10, Tirane
9	"M.S Import- Eksport" sh.p.k	Rr."Dëshmoret e 4 shkurtit" Pall.Leskova. Ap.17.Tirane
10	"American Capital Group" sh.p.k	Rr."Donika Kastrioti" Nr.14 Suite 400, Tiranë
11	"KEON" shpk	Rr."Dibrës" 400/4 Tiranë
12	"Babasi COO" shpk	Arramerras, Fushe-Krujë
13	"Trust Partners" sh.p.k	Rr."Sabaudin Gabrani " Ish SMT
VITI 2011		
14	"Military Sitems Trade Company" sh.p.k	Rr. "Elbasanit" Vila 71 Tiranë
15	"Horanlliu" sh.p.k	Rr."Shemsi Haka" Nr.26, Tiranë
16	"TMC-Albania" shpk	Rr."Irfan Tomini" P.3 Ap.17 Tiranë
17	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Rr."Bulevardi Bajram Curri" Tiranë
18	"UNIMESKO" sh.p.k	Bulevardi "Zhan D'Ark" Kompleksi "MATRIKS", Kati IV
19	"Nitro-Chem" sh.p.k	Rr."Sami Frashëri" P.Teknoprojekt Ap.4 K.2 Tiranë
20	Ndërmarrja Shtetërore "Kombinati Mekanik Poliçan"	Poliçan, Skrapar
21	Deutsche Marketing Geselleschaft	Rr. Ismail Qemali, Pallati Mbi Banken Amerikane Ap A-8, Tiranë,
22	A&A Security Survey shpk	Rr. Lord Bajron, Vila Nr. 1, Tiranë
VITI 2012		
23	Caswick sh.p.k	Pallati 9 Katwsh, firma ANA, Kashar, Tiranë
24	Vesel Abdulaj	Lagj. 30 Dhjetori, Berat



